

Besnik Smakaj

Kushtetues – Administrativ

Sistemi Zgjedhor në Kosovë 2001-2021 – Sfidat dhe Perspektivat

Abstrakti

Zgjedhjet janë thelbi i demokracisë apo mjeti me të cilin ajo vihet në funksion. Demokracia, në të gjitha format e saj, bazohet në sistemin e zgjedhjeve, me të cilat krijohet struktura qeverisë së një vendi, sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në formimin dhe kontrollin politik të qeverisjës dhe pushtetit, si dhe mundësohet pluralizmi politik.

Demokracia funksionon nëpërmjet zgjedhjeve periodike, në të cilat krijohet legjitimiteti politik dhe merret mandati për qeverisjen e vendit.

Zgjedhjet janë element shumë i rëndësishëm i demokracisë, të cilat duke qenë korrektuese të saj, përsosin dhe ngrisin nivelin e qeverisjës dhe bëjnë të mundshëm konkurrencën permanente të programeve qeveritare. Pushteti buron nga zgjedhjet, të cilat u mundësojnë qytetarëve të marrin pjesë në funksionimin e politikave publike.

Pushteti shtetëror dhe qeveria legjitimohen përmes zgjedhjeve. Asnjë qeveri dhe pushtet që nuk buron nga zgjedhjet e lira dhe demokratike, nuk ka legjitimitet demokratik. Përmes zgjedhjeve, qytetarët me të drejtë vote marrin pjesë në jetën publike, duke zgjedhur institucionet përfaqësuese, të cilave u japin mandatin përudhëheqjen e vendit për një periudhë të caktuar.

Element mjaft i rëndësishëm i zgjedhjeve si proces demokratik, është edhe sistemi zgjedhor që zbatohet në një shtet të caktuar.

Po aq sa janë të rëndësishme zgjedhjet për demokracinë, aq është i rëndësishëm edhe sistemi zgjedhor për konsolidimin e demokracisë përfaqësuese.

Ekzistojnë disa mënyra të ndarjes së mandateve, e rrjedhimisht edhe disa lloje të sistemeve dhe nënsistemeve zgjedhore. Ndër më të rëndësishmet janë: Sistemi mazhoritar apo i shumicë s, sistemi proporcional dhe sistemi i përzier.

Kosova në dhjetë vitet e para tëpërvojës parlamentare ka aplikuar sistemin proporcional me lista të hapura dhe të mbyllura.

Fillimisht është aplikuar sistemi zgjedhor me lista të mbyllura e pastaj është kaluar në lista të hapura. Gjithashtu një përparim është bërë edhe perkitazi me pragun zgjedhor dhe me numrin e kandidatëve për deputet në listën zgjedhore.

Të gjitha proceset zgjedhore në Kosovë nga viti 2000 e deri më tani kanë pasur vështirësitë e veta dhe nga këto procese janë nxjerrë edhe mësimet të rëndësishme të cilat shpalosin si përparësitë, ashtu edhe mangësitë e sistemit zgjedhor në Kosovë, duke pasqyruar edhe nevojën e pashmangshme të reformimit të sistemit zgjedhor.

Fjalë kyçe: demokracia, sistemi zgjedhor, proceset zgjedhore, reforma.